



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:211274

Datë: 26.03.2021

Numri i dokumentit: 01637294

**P.nr.203/2019**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN**, gjyqtari **Sulltan Dobraj**, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit Z. H. nga fshati .....K....., i akuzuar sipas PTH nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.2003/2019 te dt. 23.09.2019** për veprën penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit gjyqësorë me dt. 24.02.2021 në prezencën e PTH nga Peja Arlinda Gacaferri të pandehurit dhe të dëmtuarit J. L., me dt.26.02.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. **26.03.2021** përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri Z. H.** i lindur me dt..... ne fshatin .....K- ....., ku dhe tani banon, i biri i Bajramit dhe nënës Hajrie e vajzërisë Shabani, me numër letërnjoftimi nr....., me numër tel....., shqiptar, shtetas i Kosovës, gjendet ne liri.

Në bazë të nenit 364 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPPK-ës

### **LIROHET NGA AKTAKUZA**

**Për shkak se:**

Nga mbrëmja e dt.25.04.2019 e gjer në mëngjesin e dt. 26.04.2019 në rrugën “.....” në ..... më qellim që vetes ti sjell përfitim pasuror te kundërligjshëm merre pasurinë e te dëmtuarit J. L. pronar i kompanisë “.....” me seli në ....., ne atë mënyrë qe i pandehuri nga bageri i kësaj kompanie i cili një dit me herët ishte i parkuar në adresë te lartcekur merre dy bateri, rreth 300 litra naftë dhe 5 litra vaj motori, dhe largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush.

- **me çka kishte për të kryer vepër penale vjedhja nga neni 325 par 1 të KPRK-së**

**Nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet.**

Shpenzimet procedurale penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m**

PTH nga Peja me akuzën **PP/II.nr.2003/2019 te dt. 23.09.2019**, ka akuzuar të pandehurin Z. H. nga fshati .....K....., për veprën penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së, ka propozuar të caktohet dhe te mbahet seanca shqyrtimit gjyqësore, të administrohen te gjitha provat e duhura e me ne fund i pandehuri te shpallet fajtor dhe të dënohet në baze të ligjit.

Gjykata me dt.24.02.2021 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim gjyqësor i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë.

Meqenëse i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë gjykata ka administruar provat personale duke procedura dëshmitarët B. A. dhe të dëmtuarin J. L. si dhe materiale foto dokumentacionin e vendit te ngjarjes, hartografin ne numrin e te pandehurit të nxjerrë nga PTK.

### **Dëshmitë e dëshmitarëve**

#### **Deponimi i dëshmitarit B. A. ,**

Dëshmitari B. A. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar: pas përfundimit te orarit të punës e kam parkuar Bagerin në rrugë qe emrin e saj nuk po me kujtohet, para dyerve te shtëpisë se një familje, dhe e kam fikur, e kam mbyllur dhe kam shkuar për shtëpi. Të nesërmen kur kam shkuar për te filluar orarin e punës, e kam pare se kapakët e baterive ishin te hapura, dy bateria ishin te hequra, kapaku i rezervarit te naftës ishte i hapur si dhe 5 litra vaj te motorit ishin te marr. Unë e di se sa litra naftë i lo gjithherë ne rezervarë te ekskavatorit dhe kam vërejtur se mungonin rreth 300 litra naftë te eskavatorit kanë qen te hequra. Me pare nuk e kemi lënë ekskavatorin ne atë vend por atë dite ka qen dita e parë.

#### **Deponimi i të dëmtuarit J. L.,**

Dëshmitari J. L. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se: Unë jam menagjer në kompaninë ....., për këtë rast unë jam njoftuar nga punëtori B. A. siç dëshmoj edhe tani këtu në seancë, për vlerën e dëmit me mirë e dinë dëshmitari B. A. sepse ai është marrë vazhdimisht me eskavatorin, por për afërsisht vlera e dëmit shkon diku rreth 500 euro.

#### **Mbrojtja e të pandehurit ne shqyrtimin gjyqësorë**

I pandehuri ne shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se: Unë kam punuar dy vite te ....., e di që ka qenë natë bajrami një herë dhe asnjë cent nuk e kisha ne xhep, e kanë thirrë S. babën e J. apo këtë J. ja kamë treguar hallin dhe për një kohe shumë te shkurt me kanë thënë hajde në kryq të ..... dhe merri paret, unë nuk e di se a mund te jau kthej për të mirë, dhe shtrohet pyetja se si ka mundësi unë ta bëjë këtë gjest ndaj këtyre që mua me kanë ndihmuar aq shumë.

### ***Fjala përfundimtare e prokurorit te shtetit.***

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se: së pari bënë përmisim te kohës se kryerjes se veprës penale duke filluar nga mbrëmja e dt. 25.04.2018 gjerë ne mëngjesin e dt. 26.04.2018, pas administrimit te provave është vërtetuar përtej dyshimit te bazuar mirë se i akuzuari Z. H. me dt.26.04.2018 rreth orës 08:00 ne ..... ne rrugën ..... me qellim që vetës ti sjell dobi pasurore ne mënyre të kundërligjshme merr pasurin e të dëmtuarit J. L. pronar i kompanisë ..... me seli në fshatin ....., në atë mënyrë që i pandehuri nga bageri i kësaj kompanie i cili një ditë me herët ishte parkuar ne adresë te lartcekur merr dy bateri rreth 300 litra naftë dhe 5 litra vaj për vetura dhe largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush, me çka ka kryer penale te vjedhjes nga neni 325 par.1. të KPRK-ës se eskavatori ka qenë i parkuar ne rrugën .....këtë e vërteton dëshmitari B. A. e ne këtë shqyrtim gjyqësor ku i njëjti ka deklaruar se vetë e ka parkuar ne atë vend eskavatorin dhe të nesërmen ku ka shkuar për ta marr ka vërejtur se i mungojnë 2 bateritë,5 litra vaj të motorit dhe 300 litra naftë. Lidhur me vlerën e dëmit të shkaktuar në këtë shqyrtim gjyqësor është dëgjuar i dëmtuari J. L. i cili ka deklaruar se vlera e dëmit është diku rreth 500 euro. Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë është dëgjuar edhe i akuzuari Z. H. por i njëjti gjatë gjithë kohës duke ikur përgjegjesisë ka deklaruar pa kuptim ku ka pranuar se dy herë gjatë natës është larguar nga vendi i punës një herë është takuar me një mik e herën tjetër kinse ka shkuar te kali, por qe deklarata e tij është ne kundërshtim me atë te cilën e ka dhëne ne polici ku atje ka deklaruar se atë natë nga vendi i punës është larguar dy herë dhe ka shkuar ne shtëpi pasi që i ka pjellë lopa dhe është dashur ti ndihmoj. I akuzuari ne këtë shqyrtim gjyqësorë nuk e ka cekë fare se atë natë ka qenë edhe ne fshatin .....pasi qe nga zyra ligjore të PTK-Vala është nxjerr hartografia e thirrjeve telefonike ku ka rezultuar se kanë bërë thirrje nga ana e të dyshuarit te cilat ishin regjistruar nga antena telefonike ne fshatin ..... Nga e gjithë kjo duhet te kuptojmë si i akuzuari atë natë ka qenë ne rrugën .....dhe i njëjti e ka kryer veprën për të cilën është akuzuar, andaj mbetem ne tersi pranë aktakuzës dhe kërkoi që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të merr dënimin e merituar.

### ***Analiza dhe vlerësimi i provave***

Gjykata me asnjë prove nuk ka mundur ta vërtetoj se i akuzuari te ketë kryer veprën veprën penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së siç është cekur ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

### ***Fakti jokontestues***

- Nuk është kontestues fakti se të dëmtuarit ju kanë vjedhur 2 bateri,300litra naftë dhe 5 litra vaj të veturës.
- Nuk është kontestues fakti për palët se është kryer vepra penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së ne dëm të dëmtuarit J. L..

- Nuk është kontestues fakti se i pandehuri dy herë gjatë natës është larguar nga vendi i punës.

### **Fakti kontestues**

Gjatë shqyrtimit gjyqësorë për palët ka **qenë kontestuese se a është** pandehuri kryes i kësaj vepre penale.

Për te vërtetuar këtë fakt gjykata ka analizuar dhe vlerësuar provat personale dhe materiale, te cilat i ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësorë, por nuk ka mundur te gjen asnjë element me te cilin do te vërtetohej se i pandehuri ti ketë marrë 2 bateritë, 5 litra vaj të motorit dhe 300 litra naftë siç ceket ne dispozitiv.

### **Vlerësimi i provave personale**

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar dëshminë e dëshmitarit B. A. nga e cila dëshmi gjykata e ka vërtetuar se eskavatori është parkuar ne mbrëmjen e datës 25.04.2018 dhe kur ka shkuar të nesërmen të datës 26.04.2018 e ka gjetur eskavatorin me kapak të baterive të hapur, kapakun e rezervarit të hapur dhe të marrura 2 bateri, 300 litra naftë dhe 5 litra vaj të motorit, por nga kjo dëshmi nuk është vërtetuar asnjë element i cili do të vërtetonte faktin se i pandehuri është kryesi i kësaj vepre penale apo personi që i ka marr ketë sende.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar dëshminë e të dëmtuarit J. L. nga e cila dëshmi nuk ka mundur të vërtetohet asnjë element me te cilin do të vërtetohej se i pandehuri është kryes i veprës penale.

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar foto dokumentacionin dhe hartografin të nxjerr nga PTK mirëpo gjykata nuk ka mundur të gjene asnjë element më të cilin do të vërtetohej se i pandehuri natën kritike te ketë qenë ne rrugën .....në .....

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar foto dokumentacionin ku shihet eskavatori, mirëpo nga ky foto dokumentacion nuk mund të vërtetohet se i pandehuri është ai personi i cili i ka marrë sendet e cekura më lartë

Gjykata e ka analizuar edhe mbrojtjen e të pandehurit nga e cila mbrojtje gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka thënë të vërteten ne mbrojtjen tij kur ka deklaruar se natën kritike nuk ka qenë në rrugën Dëshmoret e Deçanit, kjo mbrojtje e tij është në harmoni edhe më hartografin ku hartografia vërteton faktin se i pandehuri nuk ka qenë ne rrugën Dëshmorët e Deçanit.

### **c) Vlerësimi juridik i çështjes**

- Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit te gjitha provave personale dhe materiale një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën ,ka nxjerre përfundim se me asnjë provë nuk është provuar se i pandehuri te ketë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së.

Gjykata me asnjë prove nuk ka mundur të vërtetoj se i pandehuri ti ketë marrë sendet si 2 bateri, 300 litra naftë dhe 5 litra vaj të motorit, siç ceket ne dispozitiv.

- Gjykata duke i vlerësuar pretendimet e paraqitura në aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Pejë, se i akuzuari me qëllim të përfitimit pasuror ne mënyre të kundërligjshme merr pasurin e tjetrit përkatësisht të dëmtuarit J. L. dhe atë 2 bateri, 300 litra naftë dhe 5 litra vaj të motorit me çka kishte për të kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së është gjetur se aktakuza **nuk është e bazuar**.

- Gjykata duke u bazuar ne institutin juridik : “**IN DUBIO PRO REO - NE RAST MEDYSHJE NE FAVOR TE PANDEHURIT**”, ka vendosur dhe e ka liruar te akuzuarin nga akuza, sepse me asnjë prove te drejtpërdrejte dhe as rrethanore nuk ka mundur të vërtetohet se i pandehuri te jetë kryes i veprës penale vjedhje nga neni 325 paragraf 1 të KPRK-së.

Gjykata në rastet kur nuk vërtetohet në tërësi me prova se i pandehuri ka kryer vepër penale e liron atë nga aktakuza sepse nuk mund të shpallet fajtor një i pandehur në bazë të dyshimeve dhe mëdyshjeve.

Nga sipërpërmendur e ne vështrim me dispozitën e nenit 364 par. 1. Nën par.1.3 te KPPK-ës, është vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Në bazë nenit 454 paragraf 1 te KPPK-së i pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, ndërsa të njëjtat shpenzime do të paguhen nga mjetet buxhetore te gjykatës.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA KOMUNALE NË DEÇAN,  
P. nr. 203/2019 te dt.26.03.2021**

**Sekretarja juridike**

**Sabiha Hoxha**

**G j y q t a r i**

**Sulltan Dobraj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore Pejë dega në Deçan.